

V E N D I M
Nr.433, datë 9.9.1999

**PËR PRIVATIZIMIN ME TENDER TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË
ÇIMENTOS FUSHË-KRUJË**

(Ndryshuar me VKM nr. 65, datë 24.2.2000)

(I përditësuar)

Në mbështetje të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ligjit nr.8334, datë 29.4.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.408, datë 31.8.1999 "Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Forma e privatizimit e ndërmarrjes së prodhimit të çimentos Fushë-Krujë do të jetë tenderi i hapur.

2. Procedurat e tenderit realizohen nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.408, datë 31.8.1999 "Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve shtetërore".

3. Vlerësimi i ndërmarrjes do të bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shoqërore që privatizohet dhe procedura e shitjes".

3/1. *Trajtimi i detyrimeve debitore dhe kreditore do të bëhet sipas kapitullit II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, date 20.3.1998.*

4. *Kriteret bazë të përzgjedhjes të ofertave do të jenë:*

a. *Pjesëmarrësit në tender të ketë eksperiencë të drejtëpërdrejtë në prodhimin e çimentos jo më pak se 10 vjet.*

b. *Pjesëmarrësi në tender të jetë prodhues i çimentos me një prodhimtari mesatare vjetore, në 3 vitet e fundit, jo më pak se 7 milionë tonë në vit.*

Pjesëmarrësit në tender, së bashku me ofertën, duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton :

- *Aktet e regjistrimit, ose ekuivalentët me to, të çertifikuara jo më pak se 60 ditë nga data e paraqitjes të tyre.*
- *Bilancin kontabël të audituar të paktën 3 vitet e fundit të aktivitetit.*
- *Raportin e auditorëve të huaj për 3 vitet e fundit.*
- *Një përshkrim të aktiviteteve kryesore në fushën e prodhimit të çimentos.*

c) *Vlerësimet e ofertave të përzgjedhura janë:*

- | | |
|--|----------------|
| i) <i>Niveli i investimit të propozuar</i> | <i>35 pikë</i> |
| ii) <i>Programi special për punësimin</i> | <i>10 pikë</i> |
| iii) <i>Mbrojtje e mjedisit</i> | <i>5 pikë</i> |
| iv) <i>Çmimi i ofruar</i> | <i>50 pikë</i> |

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

